



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 28 Maj 2021

Nr. 371

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin e denoncimit për shkelje të parashikuar në udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndaj Kryetarit të Bashkisë Vlorë z. Dritan Leli

Kërkues: Partia Demokratike

Ndaj: Z. Dritan Leli, Kryetar i Bashkisë

Baza ligjore: Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, 78 pika 6, dhe 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimi nr. 6, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi relacionin e administratës paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është raportuar një denoncim në ndërfaqen e “Aktiviteteve të Ndaluar”, në rubrikën “Kallëzo”, nga subjekti politik Partia Demokratike (PD), për afishimin e materialeve propagandistike nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste në Bulevardin “Ismail Qemali” dhe “Lungomare”.



Kallëzimet e paraqitura nga kallëzuesi ruhen në sistem elektronik dhe identifikohen me numër unik të gjeneruar nga sistemi. Denoncimi është raportuar më datë 03.04.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 2820 ora 10:49 dhe pretendohet se: *“Partia Socialiste Dega Vlorë ka afishuar në ambiente publike materiale propagandistike. Pa një vendim të Kryetarit të Bashkisë, i cili të përcaktojë vendet publike për afishimin nga partitë politike dhe subjektet zgjedhore të materialeve propagandistike. Në datën 30 mars, i jemi drejtuar Bashkisë Vlorë me kërkesë për përcaktimin e vendeve publike për afishimin e materialeve propagandistike gjatë fushatës zgjedhore, për të cilën, ende dhe sot nuk kemi asnjë përgjigje. Kjo përbën shkelje të Kodit Zgjedhor dhe udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.*

Bashkëlidhur këtij denoncimi janë dërguar foto ilustruese të afishimit të materialeve propagandistike nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh” dhe “f” dhe “n”, pika 2, dhe 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se, të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues Partia Demokratike përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Neni 64 i ligjit nr. 139/2015 “Për organet e vetëqeverisjes vendore” përcakton kompetencat e kryetarit të bashkisë përfshirë kompetencën për sigurimin e plotësimit të të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar



bashkisë si person juridik edhe është përfaqësues i saj në marrëdhëniet me të tretët.

Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon të vijojë procedurën administrative ndaj z. Dritan Leli, Kryetar i Bashkisë Vlorë, ndaj të cilit atribuohen veprimtari administrative, që vijnë në kundërshtim me parashikimet e neneve 78/6, 91 e 92, të Kodit Zgjedhor dhe udhëzimit nr. 6/ 2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se, të dhënat e paraqitura nga kallëzuesi Partia Demokratike, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

II.

Rrethanat e faktit

Partia Demokratike, nëpërmjet ndërfaqes “ Aktivitete të ndaluara”, rubrika “Kallëzo” ka dërguar një kallëzim, ku pretendohet se Kryetari i Bashkisë Vlorë z. Dritan Leli, në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe me udhëzimin nr. 6/2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ka lejuar vendosjen e materialeve propagandistike në hapësira publike.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet shkresës nr. 3287 prot., datë 06.04.2021, i ka kërkuar Bashkisë Vlorë të na vendosë në dispozicion vendimin për miratimin e vendeve publike për afishimin e materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore në funksion të zgjedhjeve të datës 25.04.2021, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Nëpërmjet shkresës nr. 5272/1 prot., datë 08.04.2021, protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 3628 prot., datë 12.04.2021, Bashkia Vlorë, në përmbushje të kërkesave të udhëzimit nr. 6, datë 09.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i ka njoftuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve vendimin nr. 28 datë 29.03.2021 “Për miratimin e vendeve publike për afishimin e materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore në funksion të zgjedhjeve të datës 25.04.2021 për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë”.

III

Analiza juridike dhe konkluzione

Referuar pikës 1, të nenit 79, të Kodit Zgjedhor parashikohet se... “*Jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, kryetari i bashkisë, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, përcakton vendet publike në territorin e bashkisë, përkatëse për afishimin prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike. Vendet e caktuara duhet të jenë në ambiente që sigurojnë shikueshmëri publike dhe të kenë hapësirë të mjaftueshme ku të gjitha subjektet zgjedhore që marrin pjesë në zgjedhje*



të paraqesin programet e tyre zgjedhore dhe mesazhet zgjedhore. Vendimi i kryetarit të bashkisë bëhet publik në faqen e internetit të bashkisë menjëherë pas miratimit”.

Referuar pikës 2, të nenit 79, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se... “ *Gjatë fushatës zgjedhore përdorimi dhe afishimi i çdo materiali tjetër statik për propagandë zgjedhore, përfshirë flamujt dhe posterat, lejohet vetëm në një largësi prej deri 5 metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës.*

Referuar denoncimit të mësipërm, pas hetimeve të kryera nga persona të autorizuar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rezultoi e provuar se, në hapësirat e pretenduara nga denoncuesi, ishin vendosur materialeve propagandistike në stenda afishimi. Ligji shqiptar parashikon se, subjektet private mund të pajisen me leje për shfrytëzimin e hapësirës publike për qëllime të ndryshme, ndër të cilat është dhe reklamimi. Bashkitë miratojnë rregulloret përkatëse për shfrytëzimin e hapësirave publike, duke përcaktuar afatet e lejes, dokumentacionin e nevojshëm, afatin e shqyrtimit e specifikime të tjera.

Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, stendat e afishimi konsiderohen prona private pasi për to është marrë leje specifike për shfrytëzimin e hapësirës publike.

Neni 79, pika 1, e ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, specifikon se ...”kryetari i bashkisë... **përcakton vendet publike në territorin e bashkisë**, përkatëse për afishimin e materialeve propagandistike prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore”. Stenda e afishimi, t e cila është përdorur për transmetimin e materialeve propagandistike, nuk është pronë publike, por në kuptim të përcaktimit të mësipërm ato konsiderohen prona private, me leje të posaçme për reklamim. Për sa më sipër, nuk ka ekzistuar detyrimi i Kryetarit të Bashkisë për tu shkrehur mbi këto stenda përderisa ato janë rregulluar më një ligj të posaçëm.

Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ për kallëzimin e kryer nga Partia Demokratike, pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se, denoncimi nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 79, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimin nr. 6/2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve:



V E N D O S:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimit ndaj kryetarit të Bashkisë Vlorë z. Dritan Leli.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

